



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

Deçan: Vjedhi në një qendër tregtar, iu gjet pistoletë e pastaj bashkë me vëllain kanosën verbalisht zyrtarët policorë – Arrestohen të dy



30/12/2024 09:24



Një person i armatosur dyshohet se ka kryer një vjedhje në një qendër tregtare në Deçan.

Policia e Kosovës ka arrestuar atë dhe gjatë kontrollit i është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë, si dhe gjatë kësaj kohe ai ka kanosur verbalisht tre zyrtarë policorë.

Gjatë kontrollit të Policisë në shtëpinë e tij, vëllai i tij ka kanosur gjithashtu verbalisht tre zyrtarë policorë prandaj edhe është arrestuar shkruan lajmi.net.

Dy vëllezërit janë intervistuar dhe janë dërguar në mbajtje.

“**Rr. Luan Haradinaj, Deçan / 29.12.2024-18:35.** Dyshohet se në një qendër tregtare është kryer një vjedhje nga një person i dyshuar i armatosur. I dyshuari është arrestuar dhe gjatë kontrollit në trup i është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë ndërkohë i njëjti i ka kanosur verbalisht tre zyrtarë policor. Gjatë kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit është arrestuar vëllai i tij i dyshuari mashkull kosovar pasi që i njëjti i ka kanosur verbalisht zyrtarë policor derisa ishin në bastisje. Me vendim të prokurorit dy të dyshuarit-vëllezër janë intervistuar dhe dërguar në mbajtje. Rasti nën hetime”, thuhet në raportin e Policisë së Kosovës. **/Lajmi.net/**

Më shumë nga uebi



Artikuj të ngjashëm



December 30, 2024

Shala publikon një video gjatë luftës: Sot në Ditën e Veteranit...



December 30, 2024

Prokuroria Speciale ngre aktakuzë ndaj tre personave për krime lufte në...



December 30, 2024

Kurti: Ky vit do të hyjë në historinë ekonomike të Kosovës,...



December 30, 2024

Kurti shkon për ngushëllime tek familja Krasniqi: Çdo nënë dëshmorë, është...



December 30, 2024

Rrahman Rama bën homazhe te varret e dëshmorëve: Kemi humbur shokë...



December 30, 2024

Drejtoresha e Pronës në Komunën e Prishtinës, Doruntinë Maloku lirohet nga...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information